

Specialist në Sektorin e Përpunimit të Imazheve Satelitore, në Drejtorinë e Përpunimit të Informacionit të Territorit me Teknologji të Avancuar, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Përpunimit të Imazheve Satelitore, në Drejtorinë e Përpunimit të Informacionit të Territorit me Teknologji të Avancuar, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Përpunimin dhe analizimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, të vëna në dispozicion nga institucione shtetërore si dhe të krijuara nga ASIG, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj, bazuar në manualat apo praktikat më të mira në përputhje me standardet europiane.
2. Shpërndarjen e informacionit të përpunuar gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjësive.
3. Hartimin dhe propozimin e Draft/akte-nënligjore/manuale, në bashkëpunim me institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësive, për mënyrën e përdorimit të informacionit të përfutur nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar bazuar nga përvoja ndërkombëtare dhe situata brenda vendit.
4. Ndjekjen dhe realizimin e kontrollit të cilësisë së produkteve gjeohapësinore të mbledhura/kapura nëpërmjet Shërbimeve Satelitore.
5. Kujdesjen për rritjen dhe ruajtjen e njohurive profesionale, të kuptuarit teknik dhe njohuritë praktike të punës, të metodologjive dhe përvetësimit të teknikave që lidhen me parimet dhe përdorimin e metodave të GIS dhe të Remote Sensing për të analizuar të dhënat gjeohapësinore dhe për të zgjidhur problemet për projektet që përfshijnë tematika të ndryshme.
6. Kryerjen dhe kontrollin e çdo punimi në mënyrë që produkti të jetë në përputhje me kërkesat teknike dhe saktësitë e miratuara në kuadrin ligjor në fuqi.
7. Referimin e çdo problematike të identifikuar gjatë procesit të punës dhe bën rekomandimet përkatëse.

8. Menaxhimin e bazës së të dhënave të mbledhura nga përpunimi dhe analizimi i informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, të krijuar nga ASIG apo palët e treta dhe çdo produkt tjetër lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori.
9. Sigurimin dhe përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit dhe sipas rëndësisë dhe Drejtorin e Drejtorisë lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë punës së tij.
10. Kryerjen e çdo funksioni të ngarkuar nga eprori, për realizimin e veprimtarisë së sektorit dhe ASIG.
11. Përdorimin e infrastrukturës dhe teknologjisë përkatëse të përpunimit dhe të analizimit të informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, në përputhje me kërkesat e hartës bazë.
12. Kontrollin e çdo informacioni gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, të vëna në dispozicion nga institucione shtetërore si dhe të krijuara nga ASIG, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj.
13. Përfaqësimin e institucionit në takime pune dhe konferenca lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori, sipas propozimit të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratim të Drejtorit të Përgjithshëm.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të ketë mbaruar studimet e larta e të zotërojë diplomë “Master Profesional”, diplomuar në Gjeodezi, Gjeoinformatikë, Gjeomatikë dhe “Master profesional GIS”.
2. Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.
3. Të ketë njohuri të thelluara teorike dhe praktike lidhur me proceset e domosdoshme në përdorimin e teknologjive të avancuara (Remote Sensing).
4. Të ketë njohuri të legjislationit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinor.
5. Të ketë njohuri të thelluara në përdorimin e softuerit për analizimin e imazheve satelitore ose Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) si: ArcGIS, QGIS, ERDAS, ENVI, etj, për të vlerësuar dhe analizuar të dhënat e marra nga sistemet Remote Sensing.
6. Të ketë njohuri të thelluara teorike lidhur me transformimin e informacionit gjeohapësinor nga një referencë gjeodezike në një tjetër.
7. Të dokumentojë dhe të zhvillojë rezultate si nga kërkimet shkencore dhe teknike bazë ashtu edhe ato të aplikuar për përdorim në raportet teknike dhe publikimet.
8. Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.
9. Të ketë aftësi të mira komunikimi, propozimi dhe menaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi.
10. Të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 20.01.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.

Pas datës 20.01.2024 aplikantët të cilët kalojnë fazën e parë të vlerësimit do të njoftohen me e-mail për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.